



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:177970

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06291742

C.nr.4778/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjykatësit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëseve - propozuesve të masës së sigurimit A.(H).S dhe H.H, të përfaqësuar mbi bazën e autorizimit (prokurës) nga XH.M, avokat me seli në F, kundër të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit: 1) B.H, i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga B.H, avokat me seli në P; 2) V.(F).Z, i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga A.J, avokat me seli në P; 3) V.H-U, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga Zyra për Shërbime Juridike "A", me seli në P; 4) B.(Y).B; 5) A.(R).B dhe 6) V.(E).B, me objekt kontesti anulimin e kontratave mbi dhuratën dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 14.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË E PALEJUESHME padia e paditëseve A.(H).S dhe H.H, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, e cila evidentohet nën shenjën C.nr.4778/23, e dt.22.08.2023, kundër të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit: 1) B.H; 2) V.(F).Z; 3) V.H-U; 4) B.(Y).B; 5) A.(R).B dhe 6) V.(E).B, me objekt kontesti anulimin e kontratave mbi dhuratën dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate është duke u zhvilluar procedura kontestimore sipas padisë së paditëseve A.(H).S dhe H.H, të përfaqësuar mbi bazën e autorizimit (prokurës) nga XH.M, avokat me seli në Ferizaj, kundër të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit: 1) B.H; 2) V.(F).Z; 3) V.H-U; 4) B.(Y).B; 5) A.(R).B dhe 6) V.(E).B, me objekt kontesti anulimin e kontratave mbi dhuratën dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me propozim për caktimin e masës së sigurimit.

Përmes parashtrësës së deponuar në Gjykatë, jashtë seancës gjyqësore me dt.26.07.2024, paditëset - propozueset e masës së sigurimit e kanë bërë zgjerimin e padisë - propozimit për masë të sigurimit në aspektin subjektiv, duke përfshirë në cilësinë e palëve të paditura - kundërshtarëve të sigurimit edhe B.(Y).B, A.(R).B dhe V.(E).B.

Me rastin e pranimit të kësaj parashtrëse, Gjykata i është referuar dispozitës nga neni 305 të LPK-së, e cila përcakton që: *"Përveçse në rastet e përcaktuara me këtë ligj, masa e sigurimit nuk mund të caktohet po që se kundërshtari i sigurimit nuk ka pasur mundësinë që të deklarohet për propozimin*

e caktimit të saj. Propozimin për caktimin e masave të sigurimit gjykata, bashkë me shkresat që i janë bashkangjitur, ia dërgon kundërshtarit të sigurimit me njoftim se mund të paraqesë përgjigje të shkruar brenda afatit shtatë (7) ditor”. Në referim të dispozitës së lartëcekur, Gjykata përmes njoftimit të dt.07.08.2024, padinë me propozim për caktimin e masës së sigurimit ka tentuar t’ua dërgojë kundërshtarëve të sigurimit B.(Y).B, A.(R).B dhe V.(E).B, në mënyrë që t’ua ofrojë mundësinë e paraqitjes së përgjigjes në formë të shkruar, brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të njoftimit.

Shkresat e lartëcekura, Gjykata ka tentuar që të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit të lartëcekur, t’ua dërgojë në adresat e vëna në dispozicion nga propozueset e masës së sigurimit, Prishtinë, Rr. “S.D” nr..., me ç’rast nga fletëdërgesat postare janë kthyer konstatimet “*i panjohur*”, duke e pamundësuar komunikimin e rregullt.

Përmes aktvendimit të dt.19.08.2024, paditëset janë obliguar që në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit ta plotësojnë padinë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit, duke i vënë në dispozicion adresat e sakta të vendbanimit për të paditurit - kundërshtarët e sigurimit B.(Y).B, A.(R).B dhe V.(E).B. Përmes parashtresës së deponuar në Gjykatë me dt.26.08.2024, paditëset, përmes përfaqësuesit të autorizuar e kanë njoftuar Gjykatën se të paditurit e lartëcekur nuk gjenden në Kosovë, por në shtetin gjerman dhe nuk kanë njohuri lidhur me adresat e sakta të tyre. Tutje është propozuar që në kuptim të nenit 79 par.3 të LPK-së, të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit tu caktohet përfaqësuesi i përkohshëm nga rrada e avokatëve.

Në një situatë të tillë, Gjykata ka konkluduar se në adresat të cilat janë vënë në dispozicion, të paditurit - kundërshtarët e sigurimit B.(Y).B, A.(R).B dhe V.(E).B, rezultojnë të panjohur, rrjedhimisht Gjykata e ka të pamundur komunikimin me të njëjtit. Në këtë kuptim, me qëllim të evitimit të kësaj të mete e në funksion të procedimit të mëtutjeshëm në këtë çështje juridike, janë plotësuar prezumimet procedurale që të veprohet në kuptim të dispozitës nga neni 79 par.3, pika a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ku shprehimisht përcaktohet: “*Gjykata do t’i caktojë palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste: a) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë*”. Në anën tjetër, dispozita e nenit 81 par.2 e LPK-së, përcakton që: “*Në rastet nga paragrafi 2 i nenit 79 të këtij ligji, i padituri ka për detyrë të deponojë shumën e të hollave për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastet nga paragrafi 3 i të njëjtit nen shpenzimet i deponon paditësi*”. Bazuar në rrethanat e lartëcekura, në kuptim të dispozitave të cituara më lartë, Gjykata ka marrë aktvendimin e dt.06.09.2024, përmes të cilit në pikën I të dispozitivit janë detyruar paditëset që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të deponojnë në xhirollogarinë bankare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, përmes arkës së kësaj gjykate, shumën e të hollave në vlerë prej 4,500.00 € (katër mijë e pesëqind Euro), në emër të shpenzimeve të cilat do të krijohen rreth caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit - kundërshtarët e sigurimit B.(Y).B, A.(R).B dhe V.(E).B, tani me adresë të panjohur të vendbanimit, ndërsa Gjykatës t’ia prezantojnë dëshminë për deponimin e bërë. Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, paditëset janë paralajmëruar lidhur me faktin që në rast se nuk përmbushet obligimi i përcaktuar nga pika I e dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata do ta hedhë poshtë si të palejueshme padinë me propozim për caktimin e masës së sigurimit, në kuptim të dispozitës së nenit 391 par.1 pika g) të LPK-së.

Aktvendimin e lartëcekur, paditëset rezultojn që e kanë pranuar në mënyrë të rregullt përmes përfaqësuesit të autorizuar me dt.13.09.2024, (fakt ky i cili vërtetohet në bazë të fletëdërgesës postare të nënshkruar në të njëjtën datë). Megjithatë, Gjykata deri më tani nuk ka disponon me ndonjë dëshmi në drejtim të vërtetimit të faktit se paditëset kanë vepruar konform obligimit të dhënë nga ana e gjykatës brenda afatit të përcaktuar prej 7 (shtatë) ditësh, i cili është i karakterit gjyqësor. Në një situatë të tillë, duhet referuar dispozitës nga neni 391.1, pika g), të LPK-së, e cila përcakton se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: g) paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të këtij ligji”*.

Bazuar në faktin se palët paditëse nuk i kanë evituar të metat nga neni 79 të LPK-së, përkundër udhëzimeve të dhëna nga ana e Gjykatës dhe paralajmërimit lidhur me pasojat procedurale, e në rastin konkret evitimi i këtyre të metave është parakusht thelbësor për procedim të mëtutjeshëm në këtë çështje kontestimore, bazuar në dispozitën e lartëcekur nga neni 391 par.1 pika g) të LPK-së, Gjykata erdhi në përfundim se padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme. Gjykata vë në dukje faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësi unike, i cili lloj i bashkëndërgjyqësisë është parashikuar dhe normuar me dispozitën e nenit 269 par.1 të LPK-së, i plotësuar me nenin 17 (sipas Ligjit nr. 04/L-118, për ndryshimin dhe plotësimin e LPK-së), ku është përcaktuar se: *“Në qoftë se sipas ligjit ose për shkak të natyrës së raportit juridik kontesti mund të zgjidhet vetëm në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve (bashkëndërgjyqësia unike), atëherë ata të gjithë konsiderohen si një palë ndërgjyqëse e vetme, kështu që në rastin kur ndonjëri nga bashkëndërgjyqësit nuk e kryen ndonjë veprim procedural, efekti i veprimeve procedurale të kryera nga bashkëndërgjyqësi tjetër shtrihet edhe në ata që nuk i kanë kryer veprimet e tilla”*. Mbi këtë bazë, vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se mos evitimi i të metave nga neni 79 i LPK-së, në raport me disa të paditur, domosdoshmërisht prodhon efekte në raport me marrjen e vendimit ndaj gjithë të paditurve, përderisa kërkesat e drejtuara burojnë nga e njëjta bazë faktike dhe juridike. Mbi këtë bazë, vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 450 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.”*

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.4778/23, datë 14.10.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.